



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:247068

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06373732

Ac.nr.2652/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.S. nga Prishtina, me vendbanim në lagjen ... Ndërtesa K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore “H. & P.” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), me seli në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj”, me bazë juridike kompensim i dëmit material dhe jo material nga heqja e lirisë pa bazë, duke vendosur sipas ankesave të palëve në procedurë, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.564/2014, të datës 27.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I.REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit B.S. nga Prishtina, ndërsa pjesërisht pika I, e dispozitivi lidhur shpenzimet e procedurës penale, si dhe pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.564/2014, të datës 27.01.2021, VËRTETOHET.

II.APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.564/2014, të datës 27.01.2021, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me dëmin jo material në emër të frikës dhe dhimbjeve shpirtërore dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: DETYROHET i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), me seli në Prishtinë, që paditësit B.S. nga Prishtina, t’ia kompensoj dëmin material dhe jomaterial në emër të frikës dhe dhimbjeve shpirtërore shumën prej 7,000.00 euro, me kamatëvonesë të llogaritur si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë (27.01.2021) deri në pagesën definitive, ndërsa pjesa e tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar refuzohet e pabazuar.

A r s y e t i m

Gjykatës e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.564/2014, të datës 27.01.2021, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.S. nga Prishtina, dhe ka detyruar të paditurin Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë që Paditësit t'ia kompensojë: -Në emër të frikës sekondare dhe dhimbjeve e vuajtjeve shpirtërore për të gjitha kategoritë dhe intensitetet, shumën 20,000.00€, me kamatëvonesë të llogaritur si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. -Në emër të shpenzimeve të shkaktuara në procedurën penale gjatë mbrojtjes dhe deri në lirim nga akuzat për vepra penale, shumën 6'508.00€, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën dy, ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.S. nga Prishtina përtej shumave të gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në pikën tre, ka detyruar të paditurin Këshilli Gjyqësor i Kosovës që t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës si në këtë çështje, në shumën 2'671.20€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga data e marrjes së aktgjykimit, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit ashtu që të ndryshoj aktgjykimin e atakuar sa i përket lartësisë në emër të dhimbjeve dhe vuajtjeve shpirtërore, dëmit mbi bazën e të ardhurave, fitimit të humbur si dhe shpenzimeve të procedurës penale, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%.

Ankesë në afatin ligjor, kundër aktgjykimit të atakuar ankesë ka ushtruar i padituri për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj në tërësi ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim për vendosje meritore apo të njëjtin ta ndryshoj dhe paditësit t'ia njoh të drejtën e kompensimit konform udhëzimit administrativ 04/2015, për zbatimin e procedurës së kompensimit të dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa bazë.

Përgjigje në ankesë e të paditurit ka ushtruar paditësi duke i konsideruara të paqëndrueshme pretendimet e palës së paditur, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të veproj si në petitumin e ankesës së palës paditëse.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

*-Ankesa e paditësit është e pathemeltë, ndërsa ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 21.02.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit material dhe jo material nga heqja e lirisë pa bazë, të precizuar në fjalën përfundimtare me parashtrësën e datës 26.01.2021, duke kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensojë në emër

të dëmit jomaterial dhe material shumë si në precizim, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit. I padituri përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë por vetëm lartësinë e kërkuar.

Gjykata duke vepruar sipas padsisë dhe kërkesëpadsisë së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.564/2014, të datës 27.01.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadsinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me provat e administruara, nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë së paditësit për kompensim të dëmit material dhe jo material, mirëpo kontestuese në mes të palëve mbeti lartësia e kompensimit të dëmit si dhe kategoritë e kërkuara për kompensim të dëmit për shkak të heqjes së lirisë pa bazë të paditësit. Gjykata nga ekspertiza e psikiatrisë ka konstatuar se pacienti nuk ka ndonjë veçori patologjike dhe gjatë periudhës së paraburgimit prej 141 ditësh ka përjetuar vuajtje e dhimbje shpirtërore dhe frikë të llojit dhe intensitetit të ndryshëm, dhe se i njëjti ka pësuar dhimbje shpirtërore për shkak të padrejtësisë që i është bërë nga vënia në barrë e akuzave për veprë penale, si pasojë e së cilës ka hyrë në grevë urie – si pasojë e së cilës edhe ka humbur në peshë. Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadsinë e paditësit, si në pikën II të dispozitivit të aktgjyimit të atakuar, për dëmin material dhe jomaterial përtej shumëve të gjykuara, bazuar në mendimet e ekspertëve andaj, në bazë të cekurave ka vendosur për aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadsisë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, mirëpo gabimisht është zbatuar e drejta materiale, për çka edhe kjo pjesë e dispozitivit të Aktgjyimit të atakuar, është dashur të ndryshohet, për sa i përket kërkesës për kompensim të dëmit jo material për shkak të qëndrimit të paditësit për 141 ditë në paraburgim në mënyrë të paarsyeshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërisht të kërkesëpadsisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, mirëpo gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka caktuar shpërblimin e dëmit si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar, përkatësisht të njëjtën e ka caktuar të lartë, në raport me të mirën e cënuar, qëllimin e shpërblimit të dëmit, kriterëve të përcaktuara për lartësinë e dëmit të tillë dhe praktikën gjyqësore.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësisë së të

paditurës KGJK për kompensimin e dëmit (bazën juridike të kërkesëpadisë), i pranon në tërësi Gjykata e Apelit, pasi që me të drejtë vërtetimi i kësaj baze bazohet në provat materiale përkatëse, por edhe baza juridike e kërkesëpadisë nuk kontestohet as nga e paditura. Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit, e cila nuk ishte kontestuese nga pala e paditur.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin në raport me dëmin material në emër të shpenzimeve të shkaktuara në procedurën penale gjatë mbrojtjes e deri në lirim nga akuza për veprë penale, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e refuzoi ankesën e të paditurës, dhe e vërtetoi pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, duke vlerësuar se shumica e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për këtë formë të dëmit të shkaktuar, është mbështetur në provat të cilat i ka ofruar pala paditëse dhe të cilave gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin, e të cilave edhe gjykata e shkallës së dytë u falë besimin e plotë sepse ato janë bazuar në procedurën penale ku janë prezantuar procesverbalet e 17 seancave të shoqëruara me 5 ankesa dhe 13 parashtrësia dhe kërkesa, ndaj këto shpenzime të arsyeshme për aq sa ka zgjatur procedura penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh dhimbjet shpirtërore dhe frikës, është vendosur që të ndryshohet shumica e kompensimit në emër të dëmit të shkaktuar nga heqja e lirisë pa bazë, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, Gjykata e ankimore këtë vendim e ka mbështetur në nenin 200, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së (Ligji i RSFJ-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit), përcaktohet se: *“1. Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Gjykata e Apelit vlerëson se tani shumica e gjykuar për paditësin si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi është adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 par.2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se shumica e gjykuar si në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit, të kësaj gjykate, në emër të kompensimit për dhimbjet shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit është në proporcion me të mirën e shkelur dhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jomaterial. Përveç dhimbjeve shpirtërore që ka shkaktuar natyra e veprës për të cilën është akuzuar paditësi në shkallën e dhimbjeve gjykata ka

vlerësuar se ka ndikuar edhe kufizimi i lirisë në këtë rast si i paraburgosur për një periudhë prej 141 ditësh dhe kur këto dy rrethana janë bashkuar tek paditësi kanë ndikuar në intensitetin e dhimbjeve. Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se shpërblimi i dëmit në këtë rast është caktuar në kuptimin që të jetë i drejtë dhe adekuat me vëllimin e dëmit që ka pësuar paditësi. Kjo nënkupton se lartësia e kompensimit jepet si satisfaksion dhe motivohet nga qëllimi që t'i mundësojë paditësit satisfaksion - kënaqje të caktuar për vlerën e dëmit jomaterial duke marr parasysh rrethanat që kanë ndikuar në shkallën e të drejtave të cenuara si pasojë e procedurës penale siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, natyra e veprës për të cilën është akuzuar, moshën e të dëmtuarit, profesionin e tij dhe rrethanat familjare e shoqërore.

Nisur nga fakti se një ditë burgimi është i pa kompensueshëm, gjykata vlerësoi se me shumata e gjykuara me këtë aktgjykim, për se afërmi arrihet të kompensohet për dhimbjet e përjetuara të paditësit dhe me të arrihet ti ndihmoj paditësit që ti pranojë, si falje e gabimit të bërë nga organet përkatëse. Në nenin 154.1 të LMD-ës parashihet *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, gjykata konsideron se i padituri në rastin konkret duhet ta korrigjojë dëmin e shkaktuar paditësit me paraburgim të kundërligjshëm, i cili me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 154 dhe 200 të LMD-së, por edhe në nenin 5 paragrafi 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se *“Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”*.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga pala paditëse, si dhe pretendimet për të cilat i referohen dorëzanimet së deponuar në shumë prej 60,000.00 €, si fitim i humbur, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që është në përputhje me dispozitën e nenit 277 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare Nr.28/78 ), nga dita e marrjes së aktgjykimit (data 27.01.2021), sepse kjo dispozitë ishte në fuqi në kohën kur paditësi është mbajtur padrejhtësisht në paraburgim nga data 01.09.2005 deri me 20.01.2006, si dhe duke u bazuar në Opinionin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 dt.01.12.2020, e cila ka përcaktuar kamatën për detyrimet që kanë rrjedhë para datës 20.12.2012, prandaj pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit lidhur me kamatën e kërkuar janë refuzuar si të pabazuara. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenet 449, 452 par.2 dhe 453 të LPK-së, dhe sa i përket kësaj pike asnjëra palë ndërgjyqës në këtë pjesë të aktgjykimit nuk e ka atakuar me ankesë.

Numri i lëndës: 2019:247068  
Datë: 30.10.2024  
Numri i dokumentit: 06373732

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), dhe e) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.2652/2021, me datë 18.10.2024

Kryetare e kolegjit  
Naime Ahmeti, d.v.